

VENDIM
Nr. 138, datë 12.3.2014

**PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË
ADMINISTRATËS PUBLIKE, TRAJNIMIT E NËPUNËSVE CIVILË, SI DHE TË ÇDO INDIVIDIT TJETËR
JASHTË SHËRBIMIT CIVIL**

(ndryshuar me VKM-të nr. 349, datë 4.6.2014, nr. 70, datë 27.1.2016, nr. 687, datë 18.11.2021)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, 9 e 69 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme dhe të ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Ky vendim rregullon organizimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), funksionet e organeve të saj, marrëdhëniet institucionale me Departamentin e Administratës Publike (DAP), rregullat bazë për ofrimin e programeve nga ASPA-ja dhe tarifat për këto programe, si dhe trajnimin e nëpunësve civilë.

KREU I

ORGANET DREJTUESE TË SHKOLLËS SHQIPTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE
(ndryshuar shkronja "g" e pikës 1 me vendimin nr. 349, datë 4.6.2014; ndryshuar shkronja "gj", shtuar shkronja "h" e pikës 1, shtuar referenca në pikën 7 me vendimin nr. 70, datë 27.1.2016, ndryshuar shkronja "f" e pikës 11 me vendimin nr. 687, datë 18.11.2021)

1. Në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", këshilli drejtues i ASPA-së ka në përbërje 12 anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) kryetarin e këshillit drejtues, rektor i zgjedhur nga Konferenca e Rektorëve;
- b) një përfaqësues nga TND-ja e ministrisë përgjegjëse për arsimin, i përzgjedhur nga ministri përkatës;
- c) një përfaqësues nga TND-ja e ministrisë përgjegjëse për financat, i përzgjedhur nga ministri përkatës;
- ç) një përfaqësues nga TND-ja e ministrisë përgjegjëse për drejtësinë, i përzgjedhur nga ministri përkatës;
- d) një përfaqësues nga TND-ja e ministrisë përgjegjëse për integrimin evropian, i përzgjedhur nga ministri përkatës;
- dh) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për administratën publike;
- e) drejtorin e Departamentit të Administratës Publike;
- ë) një përfaqësues nga Dhoma Kombëtare e Tregtisë;
- f) një përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, i zgjedhur nga rektori i këtij universiteti;
- g) Një përfaqësues i shoqërisë civile, i zgjedhur nga ministri përgjegjës për administratën publike, nga radhët e organizatave jofitimprurëse me reputacion. Përvoja e këtij përfaqësuesi në organizatën përkatëse duhet të ketë qenë e lidhur me studime për administratën publike dhe/ose bashkëpunime me të.

Zgjedhja e përfaqësuesit nga shoqëria civile bëhet nga ministri përgjegjës brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

gj) Një përfaqësues i qeverisjes vendore, që është nëpunës civil i organeve të qeverisjes vendore, i propozuar nga shoqatat e qeverisjes vendore dhe i zgjedhur nga ministri përgjegjës për çështjet vendore.

h) Drejtori i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP).

2. Përfaqësuesit e zgjedhur nga universiteti, biznesi, shoqëria civile dhe shoqatat e qeverisjes vendore duhet të gëzojnë këto cilësi:

- a) të kenë shtetësinë shqiptare;
- b) të kenë integritet moral dhe profesional;
- c) të mos jenë dënuar penalisht me vendim të formës së prerë;
- ç) të mos kenë qenë kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore të paktën 3 (tri) vitet e fundit;

- d) të kenë të paktën 3 (tri) vite përvojë pune.
3. Zgjedhja e anëtarëve të përcaktuar në shkronjat “a”, “ë”, “f”, “g” dhe “gj” dhe të pikës 1 të këtij vendimi, bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij.
4. Këshilli drejtues i ASPA-së, për rregullat e votimit, agjendës së mbledhjeve e kuorumit të tyre, gjatë punës së tij bazohet në legjislacionin që rregullon organizimin dhe funksionimin e organeve kolegjiale.
5. Mbledhja e keshillit drejtues mund të thirret edhe nga drejtori i ASPA-së ose ai i DAP-it.
6. Këshilli drejtues mbledhet jo më shumë se 4 (katër) herë në vit.
7. Anëtarët e keshillit drejtues, të përcaktuar sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” dhe “h” të pikës 1 të këtij vendimi, nuk mund të dorëhiqen. Anëtarët e tjerë mund të dorëhiqen dhe të zëvendësohen nga i njëjti organ që bën përzgjedhjen e tyre. Anëtarët e dorëhequr qëndrojnë në detyrë deri në momentin e zëvendësimit të tyre.
8. Anëtarët e keshillit drejtues të parashikuar në shkronjat “a”, “ë”, “f” dhe “g” të pikës 1 të këtij vendimi, paguhen për çdo mbledhje 10 000 (dhjetë mijë) lekë. Pagesa kryhet nga ASPA dhe llogaritet në buxhetin vjetor të saj.
9. Këshilli drejtues i ASPA-së ka këto kompetenca:
- a) miraton politikat, strategjitë dhe programet e ASPA-së;
 - b) miraton projektbuxhetin;
 - c) miraton projektstrukturën organizative;
 - ç) miraton rregulloren e brendshme të ASPA-së;
 - d) miraton politikat e përzgjedhjes dhe formimit në ASPA në bashkëpunim të ngushtë me DAP-in;
 - dh) ndjek dhe mbikëqyr ecurinë e programeve formuese të ASPA-së;
 - e) miraton raportin vjetor të ASPA-së.
10. Drejtori i ASPA-së emërohet dhe lirohet nga detyra sipas kriterëve dhe rregullave të përcaktuara për anëtarët e trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.
11. Drejtori i ASPA-së ka këto kompetenca:
- a) drejton veprimtarinë e institucionit;
 - b) përgatit projektstrategjitë për keshillin drejtues;
 - c) përgatit projektbuxhetin dhe ia dërgon për miratim keshillit drejtues;
 - ç) përgatit projektstrukturën dhe ia dërgon për miratim keshillit drejtues;
 - d) përfaqëson ASPA-në në raport me të tretët dhe lidh marrëveshje me institucionet homologe e dhurues të ndryshëm;
 - dh) raporton te ministri përgjegjës për administratën;
 - e) mbikëqyr ecurinë e programeve trajnuese;
 - ë) përgatit, brenda muajit nëntor të çdo viti, programet e trajnimit, në bashkëpunim me DAP-in, dhe i dërgon brenda 10 (dhjetë) ditëve për miratim në keshillin drejtues;
 - f) lëshon vërtetimin për ndjekjen, me sukses ose jo, të programeve të trajnimit në ASPA;
 - g) përzgjedh dhe lidh kontratat me trajnerët/lektorët në përputhje me kriteret e vendosura në këtë vendim.

KREU II

BUXHETI I ASPA-së

(ndryshuar pika 1 me vendimin nr. 70, datë 27.1.2016)

1. Buxheti i ASPA-s është zë i veçantë në programin e miratuar për administratën publike në buxhetin e shtetit.
2. ASPA-ja mund të marrë donacione nga dhurues të huaj apo shqiptarë për qëllimin dhe funksionimin e saj.
3. ASPA-ja mund të sigurojë të ardhura nëpërmjet ofrimit të trajnimeve të veçanta, që mund të kërkojnë institucionet publike apo private, si dhe botimeve e kërkimeve në fushën e administratës publike.
4. Tarifat e përcaktuara në pikat 7, 8 dhe 10 të kreut III të këtij vendimi, mbledhen dhe administrohen nga ASPA-ja.

KREU III

PROGRAMET E OFRUARA NGA ASPA-ja DHE TARIFAT

(ndryshuar pika 8, shtuar pikat 9/1 e 9/2 dhe 12 me vendimin nr. 687, datë 18.11.2021

1. ASPA-ja ofron programet e trajnimit të thelluar, të vazhdueshëm dhe të përgatitjeve paraprake për kandidatët jashtë shërbimit civil.
2. ASPA-ja ofron programin e formimit të thelluar për kandidatët për kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, anëtarë të TND-së, pa pagesë. Ky program është i detyrueshëm të ndiqet.
3. ASPA-ja ofron, pa pagesë, programin e formimit të thelluar për anëtarët e TND-së të pranuar sipas nenit 29 të ligjit nr. 152/2013. Ky program është i detyrueshëm të ndiqet. Anëtarët e TND-së, të pranuar sipas nenit 29 të ligjit nr. 152/2013, që ndjekin programin e formimit të thelluar, nuk i nënshtrohen testimit në përfundim të këtij programi.
4. Programi i formimit të thelluar zgjat 280 orë trajnimi dhe zhvillohet 2 (dy) ditë në javë. Ky program realizohet brenda 6 (gjashtë) muajve.
5. Trajnerët për programin e formimit të thelluar duhet të përmbushin kriteret e përmendura në pikën 3 të kreut 6 të këtij vendimi.
6. ASPA-ja ofron program të formimit të thelluar dhe të vazhdueshëm, në bazë të të cilit trajnohen në vazhdimësi dhe në lidhje me punën nëpunësit civilë të të gjitha kategorive, si dhe çdo individ tjetër jashtë këtij shërbimi, vendas ose i huaj.
7. Personat jashtë shërbimit civil që ndjekin programin e formimit të thelluar paguajnë për çdo ditë trajnimi 5 000 (pesë mijë) lekë.
8. *Personat jashtë shërbimit civil, që me iniciativën e tyre dëshirojnë të ndjekin programin e formimit të vazhdueshëm dhe përzgjidhen nga ASPA, për këtë qëllim, paguajnë 3 000 (tre mijë)–7 000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursit.*
9. Në programin e formimit të vazhdueshëm përfshihen:
 - a) trajnimi i detyrueshëm gjatë periudhës së provës, i përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”;
 - b) trajnimi për zhvillimin e karrierës së nëpunësve të administratës publike dhe për përparimin në pagë;
 - c) trajnimin për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës;
 - ç) trajnimi me karakter të posaçëm për kryerjen e detyrave të veçanta për nëpunësit e administratës publike.
- 9/1. *Nëpunësit e administratës publike jashtë shërbimit civil trajnohen nga ASPA nëpërmjet programit të formimit të vazhdueshëm, për veprimtari administrative të lidhura ngushtësisht me detyrën, trajnime të cilat përcaktohen nga institucioni ku janë të punësuar apo nga institucione të tjera përgjegjëse për fusha të caktuara.*
- 9/2. *Nëpunësit, sipas pikës 9/1, të këtij kreu, trajnohen me fonde të buxhetit të shtetit, duke akorduar në buxhetin vjetor të ASPA-s fonde për këtë qëllim. Për të planifikuar fondet e nevojshme, ASPA bashkëpunon me institucionet që kanë nevojën për këto trajnime.*
10. ASPA-ja ofron mundësinë e përgatitjes paraprake të kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrimin e hapur për kategorinë ekzekutive, kundrejt tarifës prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.
11. Kriteret dhe dokumentet e kërkuara për personat jashtë shërbimit civil, që dëshirojnë të ndjekin programet e ASPA-së, përcaktohen nga drejtori i ASPA-së dhe bëhen publike në faqen *on-line* të ASPA-së e të DAP-it.
12. *Pagesa për kurs trajnimi llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit.*

KREU IV

TRAJNIMI I NËPUNËSVE CIVILË

(ndryshuar fjalë në pikën 4 me vendimin nr. 70, datë 27.1.2016)

1. Nëpunësi civil u nënshtrohet veprimtarive të detyrueshme, të përgjithshme dhe të veçanta të trajnimit në ASPA, në këto raste:
 - a) gjatë periudhës së provës;
 - b) me urdhër të drejtpërdrejtë të eprorit, kur shihet e nevojshme për formimin e nëpunësit civil, bazuar në vlerësimin e rezultateve në punë;
 - c) për programe trajnimi të përcaktuara nga DAP-i, në përputhje me politikat e përgjithshme të

trajnimin, për të paktën 60 (gjashtëdhjetë) orë trajnimi në vit, për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm dhe të lartë drejtues;

ç) për programet e formimit profesional për çdo hap të pagës;

d) për përshtatje profesionale, në rastet e ndryshimit të kërkesave të vendit të punës.

2. Për trajnimet e parashikuara në pikën 1 të kreut IV të këtij vendimi, nëpunësi i nënshtrohet testimit në fund të trajnimit. Trajnimi konsiderohet i ndjekur me sukses nëse merr, të paktën, 50% të pikëve në testim.

3. Procedurat për testimin dhe vlerësimin parashikohen në rregulloren e brendshme të ASPA-së.

4. Nëpunësi civil mund të trajnohet jashtë vendit, në kuadrin e përgjithshëm të programeve të trajnimit, të organizuara nga institucioni në përputhje me programet e përgjithshme të trajnimit, për një periudhë *jo më shumë se tre muaj*. Në mbarim të këtyre trajnimeve, nëpunësi duhet të rikthehet në vendin e mëparshëm të punës, për jo më pak se tre vjet.

5. Kur nëpunësi refuzon të kthehet në vendin e mëparshëm të punës, sipas parashikimit të dhënë në pikën 4 të kreut IV të këtij vendimi, ai duhet të dëmshpërblejë institucionin për shpenzimet e trajnimeve.

6. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime në institucione të tjera trajnuese përveç ASPA-së, deri në një muaj, me iniciativën e tij, por për detyrën që ai kryen, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit.

7. Nëpunësi civil mund të kryejë trajnime nga 1 (një) muaj deri në 2 (dy) vjet, jashtë apo brenda vendit, të ndërmarra me iniciativën e tij, por për detyrën që ai kryen. Gjatë kësaj kohe ai pezullohet nga shërbimi civil.

8. Të gjitha institucionet e administratës publike detyrohen që, për trajnimet e parashikuara në pikat 4, 6 dhe 7 të kreut IV të këtij vendimi, të dërgojnë informacionin pranë ASPA-së dhe Departamentit të Administratës Publike.

KREU V

PAGESA GJATË PERIUDHËS SË TRAJNIMIT

(ndryshuar pika 2 dhe ndryshuar fjalë në pikën 3 me vendimin nr. 70, datë 27.1.2016)

1. Trajnimi në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike kryhet pa shkëputje nga puna. Gjatë kohës së trajnimit nëpunësi merr pagën e plotë.

2. *Trajnimi jashtë vendit, i organizuar nga institucioni, është me shkëputje nga puna. Gjatë periudhës së trajnimit deri në tre muaj, nëpunësi merr pagën e plotë, përjashtuar shtesat për vështirësi dhe kushte pune.*

3. Për periudhën e trajnimit që kalon tre muaj, sipas parashikimit të pikës 2 të kreut V të këtij vendimi, nëpunësit i ndërpritet paga.

KREU VI

KRITERET PËR TRAJNERËT

(shtuar shkronja “ç” e pikës 1, ndryshuar pikat 2, 3, ndryshuar fjalë në shkronjën “a” të pikës 4, ndryshuar shkronja “b” e shtuar shkronja “b/1”, ndryshuar shkronja “c”, të pikës 4, me vendimin nr. 687, datë 18.11.2021)

1. Për zhvillimin e trajnimeve, ASPA-ja lidh me trajnerët një apo disa nga tipat e këtyre kontratave:

a) kontratë për trajnimin e trajnerëve;

b) kontratë për trajnimin e nëpunësve të administratës publike dhe të tjerë;

c) kontratë për hartimin e kurrikulave dhe të materialeve trajnuese.

ç) *Kontratë për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave dhe materialeve të trajnimit.*

2. *Trajnerët me të cilët lidhet kontrata, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij kreu, ndahen në kategoritë e mëposhtme:*

a) *Trajnerë të kategorisë së ulët, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master professional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 3-5 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin;*

b) Trajnerë të kategorisë së mesme, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 6-10 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin, ose trajnerët që kanë një diplomë postmaster apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe, minimalisht, 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin;

c) Trajnerë të kategorisë së lartë, trajnerët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe mbi 11 vite përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin ose trajnerët që kanë një gradë apo titull shkencor;

ç) Trajnerë të kategorisë së veçantë, trajnerët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. Kanë një diplomë të arsimit të lartë apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. Jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë apo janë kthyer në Shqipëri jo më herët se 2 vjet nga momenti i kontraktimit nga ASPA; dhe

iii. Kanë të paktën 3 vite përvojë pune në institucione/organizata/kompani ndërkombëtare jashtë vendit, të lidhura me fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin.

3. Trajnerë me të cilët lidhen kontratat e parashikuara në shkronjat “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, zgjidhen:

a) individët që kanë një diplomë “Master i shkencave” ose “Master i arteve” ose “Master profesional të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike” apo të barasvlershme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe një përvojë pune në fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin e trajnerëve ose do të hartojnë kurrikulat/materialet trajnuese ose do të vlerësojnë cilësinë e kurrikulës së trajnimit dhe materialeve trajnuese, më të madhe se 11 vjet apo kanë një gradë shkencore apo titull akademik; ose

b) individët që plotësojnë kriteret e mëposhtme:

i. kanë një diplomë të arsimit të lartë apo të barasvlershme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë;

ii. jetojnë dhe punojnë jashtë Shqipërisë apo janë kthyer në Shqipëri jo më herët se 2 vjet nga momenti i kontraktimit nga ASPA; dhe

iii. kanë të paktën 4 vite përvojë pune në institucione/organizata/kompani ndërkombëtare jashtë vendit, të lidhura me fushën përkatëse për të cilën do të ofrojnë trajnimin e trajnerëve ose do të hartojnë kurrikulat/materialet trajnuese ose do të vlerësojnë cilësinë e kurrikulës së trajnimit dhe materialeve trajnuese.

4. Masa e pagesës për trajnerët përcaktohet në kontratë dhe llogaritet në varësi të kategorisë së trajnerit e të orëve të trajnimit, përkatësisht:

a) për kontratat e parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për çdo orë trajnimi 60-minutëshe të jetë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij;

b) për kontratat e parashikuara në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për hartimin e kurrikulave apo të materialeve të trajnimit, të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi të jetë:

i. 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret e parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 3, të këtij kreu;

ii. 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për trajnerët që plotësojnë kriteret parashikuara në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij kreu.

b/1. Për kontratat e parashikuara në shkronjën “ç”, të pikës 1, të këtij kreu, masa e pagesës për vlerësimin e cilësisë së kurrikulave apo materialeve të trajnimit të nevojshme për zhvillimin e 6 orëve 60-minutëshe trajnimi të jetë 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

c) në rastet e hartimit apo vlerësimit të cilësisë së kurrikulave apo të materialeve të trajnimit për më pak ose më shumë se 6 orë trajnimi 60-minutëshe pagesa llogaritet në përpjesëtim me orët e trajnimit.

ç) në rastet e rishikimit të kurrikulave, pagesa të jetë deri në 50% të pagesës së përcaktuar sipas shkronjës “b” të kësaj pike.

5. Vendimi nr. 220, datë 13.2.2013 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve të administratës publike”, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

MASAT E PAGESAVE PËR TRAJNERËT
(shtuar një rresht me vendimin nr. 687, datë 18.11.2021)

Kategoria e trajnerëve	Masa e pagesës
I ulët	750 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
I mesëm	1000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
I lartë	1500 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi
Trajnerë të kategorisë së veçantë	3 000 lekë/orë 60-minutëshe trajnimi